

STATUT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Elanor Albania SHPK

Në bazë e në zbatim të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i cili më poshtë referohet si "Ligji Për Shoqëritë", veprimtaria e shoqërisë

Elanor Albania SHPK

do të organizohet dhe do të drejtohet sipas këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

- 1.1 Sot, më datë 07.10.2021, ne themeluesit kemi krijuar një shoqëri më përgjegjësi të kufizuar me emrin Elanor Albania sh.p.k (më poshtë referuar si "Shoqëria").
- 1.2 Themeluesit e Shoqërisë janë:
- Elanor sh.a., shoqëri e juridiksionit çek, regjistruar më datë 8 prill 1991, me numër identifikimi (NIPT) 15887219, me seli: Jemnicka 1138/1, Michle, 14000 Praga 4.
 - Shyqiri Bytiqi, shtetas shqiptar, lindur në Arllat/Drenas, në datë 01.01.1972, me nr. Personal H20101719A, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar.
 - Ariana Rozhaja, shtetase kosovare, lindur në Prishtinë, në datë 26.08.1967, me dokument identifikimi pasaportë nr. P00564190, madhore dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar.
 - Flakron Shala, shtetas kosovar, lindur nw Billens Fr, në datë 26.11.1995, me dokument identifikimi pasaportë nr. P01108402, madhore dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar.

Neni 2

Kohëzgjatja

- 2.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj tregtar për një periudhë të pacaktuar (pakufizuar).



Neni 3

Selia e Shoqërisë

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga Janos Hunyadi, Pall. Domus, Tirane.
- 3.2 Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 4

Objekti

- 4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: konsulencë financiare, tatimore, kontabile, menaxhim të burimeve njerëzore, shërbime të administrimit të ndërmarrjes dhe aktivitete të ngjashme.
- 4.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve. Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari të tjera plotësuese, që janë të dobishme ose të nevojshme për realizimin e objektit të saj, në përputhje me ligjin shqiptar.
- 4.3 Shoqëria mund të bashkëpunojë me persona të tjerë fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtari të njëjtë, të ngjashme dhe / ose të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj.


PJESA E DYTË

KAPITALI I SHOQËRISË DHE KUOTAT

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë.
- 5.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - Ortaku themelues Elanor sh.a. zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 51 (pesëdhjetë e një) lekë, që përbën 51% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
 - Ortaku themelues Shyqiri Bytyqi zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 24 (njëzetë e katër) lekë, që përbën 24 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
 - Ortaku themelues Ariana Rozhaja zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 15 (pesëmbëdhjetë) lekë, që përbën 15% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
 - Ortaku themelues Flakron Shala zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 10 (dhjetë) lekë, që përbën 10% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- 5.3 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/ të paluajtshme/ apo të drejta)



Neni 6

Përgjegjësia e kufizuar

- 6.1 Ortakët janë përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.

Neni 7

Të drejtat e lidhura me çdo kuotë

- 7.1 Çdo kuotë e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korresponduese me % që zë kuota në kapitalin e shoqërisë dhe në po atë % do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

Neni 8


Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 8.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 8.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 8.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 8.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 9

Fitimi dhe kalimi i kuotave

- 9.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- Kontibutit në kapitalin e Shoqërisë;
 - shitblerjes;
 - trashëgimisë;
 - dhurimit;
 - çdo mënyre tjetër parashikuar me ligj.
- 9.2 Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata do të bëhet te Noteri .
- 9.3 Kuotat e çdo ortaku përputhen me pjesën e tyre në kapitalin e Shoqërisë. Kuotat e tij, ortaku i Shoqërisë mund t'ua ofrojë ortakëve të tjerë të Shoqërisë ose të tretëve, duke patur parasysh se ortakët e Shoqërisë kanë përparësi për blerjen e kuotave përpara personave të

3


tretë jashtë Shoqërisë. Ortaku që dëshiron të trasferojë ose të shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim administratorit, duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i arsyeshëm, konform rregullave të vlerësimit, dhe duhet të jetë i njëjtë me atë që do t'i ofrohej dhe një personi të tretë jashtë Shoqërisë si dhe të dhënat e blerësit. Administratori brenda 15 ditëve nga data e njoftimit duhet t'ua transmetojë ortakëve të tjerë këtë kërkesë dhe ortakët e tjerë duhet të japin një përgjigje brenda 1 muaji. Edhe e drejta e parablerjes për transferimin ose shitjen e kuotave duhet të ushtrohet me shkrim duke i'u drejtuar administratorit.

- 9.4 E drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave është në proporcion me kuotat që zotëron secili prej ortakëve në këtë Shoqëri. Administratori pasi ka kaluar afati prej 1 muaji, brenda 15 ditëve i komunikon ortaku që shet kuotat e tij vendimin e ortakëve të tjerë për të blerë të gjitha ose pjesërisht kuotat e tij. Në rastë se kuotat nuk shiten brenda Shoqërisë, atëherë këto kuota, brenda 10 ditëve, duhet tu ofrohen personave të tretë jashtë Shoqërisë.
- 9.5 Transferimi dhe shitja e kuotave duhet të bëhet me akt noterial dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e ortakëve.

Neni 10

Detyrimet e Ortakëve

- 10.1 Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse ftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të përmbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.


PJESA E TRETË

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME



Neni 11

Të drejtat e Asamblesë së Përgjithshme

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët.
- 11.3 Vetëm Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
- (a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
 - (b) pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
 - (c) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose çdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencionit të dhënë nga ortakët;



- (d) bashkimin, ndarjen, riorganizimin, prishjen dhe çdo lloj transformimi të Shoqërisë;
- (e) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
- (f) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyrave të përfaqësimit;
- (g) transferimin, pjesëtimin dhe anulimin e kuotave;
- (h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- (i) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë si dhe shpërndarjen e fitimit;
- (j) miraton lidhjen e kontratave për dhënie dhe marrje të drejtash ose ekskluzivitetin për tregtim dhe prodhimin e mallrave të shoqërisë si dhe kontrata në lidhje me organet shtetërore për pjesëmarrjen në tender, ankande ose aktivitete të tjera të rëndësishme;
- (k) blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;
- (l) marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e cdo të drejte për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
- (m) të vendosë për investimet;
- (n) të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie
- (o) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të Shoqërisë;
- (p) të caktojë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të Shoqërisë;
- (q) të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose cdo pagese mbi largimin e drejtorëve, dhe nëpunësve ekzekutivë të Shoqërisë;
- (r) të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
- (s) emërimin dhe shkarkimin e likujduesve, ekspertëve kontabël te autorizuar;
- (t) emërimin dhe shkarkimin e administatoreve;
- (u) përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likujduesit, ekspertët kontabël;
- (v) mbikqyerjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët;
- (w) miratimin e rregullave të brendshme administrative dhe mbledhjes së Asamblesë;
- (x) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
- (y) përcaktimin e buxhetit vjetor;
- (z) miratimin e cdo çështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.

Neni 12


Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme

- 12.1 Vendimet që i përkasin ndryshimit të statutit, emërimit të administratorit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë merren me $\frac{3}{4}$ e votave të të gjithë ortakëve.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 12.3 Në mbledhjet e ortakëve votimi është i hapur. Në raste të vecanta dhe për çështje të vecanta, një vendim mund të merret i fshehtë nëse aprovohet paraprakisht nga Asambleja.

Neni 13

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme do të thirret nga administratorët të paktën një herë në vit, në selinë e Shoqërisë ose në cdo vend tjetër, nëse përcaktohet në njoftim.
- 13.2 Gjithashtu, ortakët të cilet përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në Asamblesë të Përgjithshme të Shoqërisë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur Asamblesë të Përgjithshme. Në kërkesën drejtuar administratorëve mund të përfshihen dhe çështjet e posacme të rendit të ditës.
- 13.3 Asambleja e Përgjithshme do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar, të dërguar nga administratorët, njoftim ky i cili duhet të merret nga ortakët ose përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande apo postës elektronike, jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi i shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të Shoqërisë.
- 13.4 Njoftimi për takimin e Asamblesë së Përgjithshme do të tregojë datën, kohën, vendin e takimit si dhe çështjet e rendit të ditës.
- 13.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qënë prezentë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.



13.6 Nëse të gjithë ortakët janë prezentë në Asamblenë e ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përmbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër, nëse të gjithë ortakët janë dakord.

Neni 14

Vendimet e marra në Asamblenë e Përgjithshme

- 14.1 Vendimet në Asamblenë e Përgjithshme, të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme, mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Vendimet në Asamblesë e Përgjithshme të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, nëse nuk është e parashikuar ndryshe në këtë statut.
- 14.2 Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 14.3 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite. Autorizimi duhet të paraqitet në mbledhjen e Asamblese.
- 14.4 Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
- 14.5 Cdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e Asamblesë, të cilët do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 14.6 Nëse mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përmbushur kuorumin, atëherë Asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 13 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

Neni 15

Përrjashtimi nga e drejta e votës

- 15.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 15.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 16

Drejtimi i mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

- 16.1 Kryetari i mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme do të caktohet nga ortakët.
- 16.2 Do të aprovohen apo refuzohen vetëm ato çështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e Asamblesë. Diskutimet mbi çështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japin pëlqimin e tyre.

Neni 17

Procesverbali i mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

- 17.1 Për cdo mbledhje të Asamblese së Përgjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.
- 17.2 Procesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
- 17.3 Kopjet e vendimeve përkatëse do t'u dërgohen ortakëve jo prezent, me letër rekomande ose poste elektronike, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit.
- 17.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbalit dhe shpërndarjen e tij.

PJESA E KATËRT

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 18

Administrimi i Shoqërisë

- 18.1 Administrimi i Shoqërisë do të bëhet nga një ose më shumë administratorë, të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme, të cilët e administrojnë bashkarisht Shoqërinë. Secili prej administratorëve mund të veprojë edhe veçmas, duke siguruar autorizimin paraprak të administratorëve të tjerë. Ky autorizim mund të lëshohet me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike. Gjithashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të caktojë kompetenca përfaqësimi individuale secilit prej administratorëve.
- 18.2 Emërimi i administratorëve prodhon efektet pas regjistrimit në Qendrën Kombatare të Biznesit.
- 18.3 Administratori mund të autorizojnë palë të treta që ta përfaqësojnë atë në transaksione të vecanta.

8

- 18.4 Administratori do të organizojë dhe menaxhojë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ai është i autorizuar të përfaqësojë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të.
- 18.5 Të drejtat dhe detyrimet e administratorit burojnë nga ligji për shoqëritë tregtare, ky Statut, vendimet e Asamblese se Përgjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 18.6 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të ligjit për shoqëritë tregtare nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Cdo emërim i bërë në kundërshtim me këtë dispozitë është i pavlefshëm.
- 18.7 Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.
- 18.8 Personat e mëposhtëm do të caktohen si administrator të shoqërisë, për një periudhë 5 (pesë) vjetecare me të drejtë ripërtëritjeje:


Shyqiri Bytyqi, shtetas shqiptar, lindur në Arllat/Drenas, në datë 01.01.1972, me nr. Personal H20101719A, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar.

Neni 19

Kompetencat e administratorit

12.1 Administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të shoqërisë;
- përfaqësimin e Shoqërisë;
- hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë;
- lidhjen e marrëveshjeve mbi dhënien e huave;
- lidhjen e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
- nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënies;
- dhënien e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënies të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;
- punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratori mund të udhëzojë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojë shumën e shpërblimit të tyre; administratori ka të drejtë të ngrejë padi dhe t'i tërheqi ato, të nënshkruajë marrëveshje gjyqësore, të mbylli marrëveshje arbitrazhi, të caktojë arbitra, të tërheqi paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresë procedimet;



- administratori ka të drejtë të marri cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë.
- Administratori është përgjegjës për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
- Administratori mbikqyr përgatitjen dhe nënshkruan e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe akteve të tjera që lidhen me të, dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqet këto dokumenta për miratim pranë Asmblesë së Përgjithshme;
- thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
- publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- administratori është përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- merr vendime mbi të gjitha çështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme.

12.2 Administratorët janë të detyruar të thërasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara;
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

PJESA E PESTË

VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET

Neni 20

Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare

- 20.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një të Dhjetorit.
- 20.2 Në fund të cdo viti financiar, administratori do të përmbushi detyrat e mëposhtme:
- (a) përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
 - (b) paraqitjen e bilancit të Shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;

(c) paraqitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.

20.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të Asamblesë së Përgjithshme së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm për miratim.

Neni 21

Fitimi i Shoqërisë

- 21.1 Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri.
- 21.2 Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe do të dorëzohet në organet tatimore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

PJESA E GJASHTË

PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 22

Prishja dhe likuidimi

- 12.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë:
- (a) me vendim të Asamblesë së ortakëve;
 - (b) bashkimi me një shoqëri tjetër;
 - (c) me vendim të gjykatës me juridiksion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
 - (d) me hapjen e procedurave të falimentimit
 - (e) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - (f) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj;
- 22.2 Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".
- Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 23


Mosmarrëveshjet

- 23.1 Në rast mosmarrëveshjes, të paparashikuara ose në kundërshtim me statutin, ortakët do të përpiqen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 23.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.
- 23.3 Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale.

ORTAKËT


Elanor sh.a.

PËRFAQSUAR NGA:
FLAKRON SHALA




Ariana Rozhaja

Përfaqësuar nga:
Shyqiri Bytyqi



Shyqiri Bytyqi



Flakron Shala

FLAKRON SHALA

